Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0788

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "ELEKTRA" L.L.C kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi i Komunës - Kaçanik në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ndriçimit publik" me numër të prokurimit 652-23-3214-2-2-1, me 11/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "ELEKTRA" L.L.C., me nr. 2023/0788 , e datës 12/10/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi i Komunës - Kaçanik lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ndriçimit publik" me numër të prokurimit 652-23-3214-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2.Kjo ankesë konsiderohet si çështje e gjykuar (Res Judicata) me vendimin 427/23 i datës 14.08.2023, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar "Res Judicata".

3. **Urdhërohet** në afat prej 5 ditësh, AK që ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "ELEKTRA" L.L.C.,

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04.04.2023, Kuvendi i Komunës - Kaçanik në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Mirëmbajtja e ndriçimit publik". Ndërsa me datën 19.09.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë "Toni Ingjiniering".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 75 000.00 €.

Me 02.10.2023, OE "ELEKTRA" L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 10.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12/10/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "ELEKTRA" L.L.C., me nr. 788/23 lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja e ndriçimit publik" me numër të prokurimit 652-23-3214-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"ELEKTRA" L.L.C., janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi ankimore: "*Edhe përkundër vendimit të OSHP-së që lënda është kthyer në rivlerësim, dhe të njëjtën AK Komuna e Kaçanikut ka qenë e obliguar që ta zbatoj gjatë rivlerësimit, AK nuk e ka zbatuar vendimin në fjalë. Se AK është e papërgjegjshëm në zbatim te Ligjit për prokurim publik e konstaton edhe fakti që ne si palë me interes kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim brenda afateve te parapara ligjore dhe AK nuk ndërmerr asnjë veprim e që për neve është mjaft shqetësuese se si ka mundësi që një AK të mos respektojë asnjë dispozitë ligjore në trajtimin e kërkesës për rishqyrtim. AK nuk ka respektuar nenin 61 te RREGULLORE Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik. 61.1 Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe në ketë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet të njoftoj me shkrim të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjalë. Pra AK nuk ka bërë pezullimin e procedurës dhe nuk ka marr asnjë veprim edhe përkundër kërkesës sonë për rishqyrtim**. *Autoriteti Kontraktues duke rekomanduar për te shpallur fitues për së dyti herë një O.E Jo normalisht te ulet ka vepruar ne kundërshtim me LPP-ne dhe rregullat qe e rregullojnë ketë fushe dhe ne kundërshtim me vendimin e Organit Shqyrtues te Prokurimit Nr. 2023/0427 te datës 14.08.2023, i cili vendim i përket këtij aktiviteti dhe AK Komuna e Kaçanikut gjate rivlerësimit nuk e ka zbatuar. Ne fazën e rivlerësimit AK vetëm e ka eliminuar OE te pare ndërsa ka vazhduar me OE te dyte me radhe*

sipas ofertës e i cili është i papërgjegjshëm ne baze te ofertës qe ka dorëzuar dhe ne baze te vendimit te Panelit Shqyrtues. Ne baze te Ofertës se prezantuar shihet qarte se O.E i rekomanduar për kontrate ne shumicën e pozicioneve ka çmim jo normalisht te ulet. Ne baze te kësaj mendojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 61 te LPP-se dhe te nenit 41 te Rregullore 001/2022. Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët. 41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e ontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës. 41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët. 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e5/6 mëposhtme :i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; i. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Ne baze te këtij neni shihet qarte se ofertat e O.E te shpallur fitues i plotëson te tri kriteret e përcaktuara. Këto kritere ligjore i plotëson edhe oferta e trete me e lire. Te nenit 41.3 te Rregullore 001/2022. Ne baze të çmimeve te prezantuara del se operatori i shpallur fitues e plotëson edhe kushtin e përcaktuar ne piken i te nenit 41.3 qe i bie se çmimi mesatar i të gjitha ofertave është 811.25 kur ja zbret 30% del se çmimi minimal i ofruar nga O.E duhet te jete 567.87. Po ashtu ne baze te kalkulimeve del se është plotësuar edhe kushti ii i nenit 41.3 pasi qe oferta e rekomanduar për kontrate është me dallim me te madhe se sa 10% prej ofertës se dyte. Për këtë aktivitet këto tri kushte i kane plotësuar te tre O.E me te lire, andaj mendojmë se AK me rekomandim për te shpallur fitues O.E ne fjale ka vepruar ne kundërshtim te rregullat e prokurimit publik. Këtë qeshteje e trajton edhe neni 61 i LPP-se i cili shume saktë i përcakton hapat se si duhet vepruar ne situatën e tille kur kemi të bëjmë me tender jo normalisht të ulet. 1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. Të këtij neni. 44 2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: 2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. 3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. Të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. 4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. Të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin. 5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. Të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen.

Ne baze te ofertave te O.E te rekomanduar për kontrate shihet qarte se i njëjti ka vendosur

çmime jo normalisht të ulet për një numër te madhe te pozicioneve, çmime te cilat janë manipulative dhe nuk përkojnë as për se afërmi me çmimet e tregut.6/6 Vetëm për krahasim po i specifikojmë disa pozicione. 1.Blerja, bartja dhe montimi i shtyllave metalike konike të galvanizuara, konike, me gjatësi 8.8m dhe lirës njëkraheshe 1.5m ne formë harku sipas detalit, me elementë përcjellës si bulonat, lidhëset, dadot etj. , komplet me klemberta dhe siguresa FRA 16A. (Ofertuesi duhet te bashkëngjite në oferte vizatimin e shtyllës nga prodhuesi, atestin e prodhuesit për shtyllën e ofruar si dhe ISO Certifikatën e prodhuesit) ..... çmimi i ofertuar 2.5 € 2.Furnizimi dhe montimi i kuadrit shpërndarës KSHE, me dimensione 1200x600x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, tabela duhet te jete metalike e galvanizuar, siç është përshkuar ne përshkrim teknike. ..... 0.5€ 3. FID 40 A etj. Njëjti ka vepruar edhe Operatori i tret me radhe Labinot Krasniqi B.I qe kane ofruar çmime jo normalisht të ulet nga të cilat vlen të listohen këto pozicione: 1. Blerja, bartja dhe montimi i shtyllave metalike konike të galvanizuara, konike, me gjatësi 8.8m dhe lirës njëkraheshe 1.5m ne formë harku sipas detalit, me elementë përcjellës si bulonat, lidhëset, dadot etj. , komplet me klemberta dhe siguresa FRA 16A. (Ofertuesi duhet të bashkangjet ne oferte vizatimin e shtyllës nga prodhuesi, atestin e prodhuesit për shtyllen e ofruar si dhe ISO Certifikatën e prodhuesit) ..... çmimi i ofertuar 8.5 € 2. Furnizimi dhe montimi i kuadrit shpërndarës KSHE, me dimensione 1200x600x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, tabela duhet te jete metalike e galvanizuar, siç është përshkuar ne përshkrim teknike ..... çmimi i ofruar 12€ 3. Ndërprerës i fuqisë As 200 A ..... çmimi i ofruar 0.5 € "Vërejtje, vlen të theksohet se me vendimin me nr. 0427/2023 e dt. 14.08.2023 për te njëjtat arsye lënda është kthyer ne ri-vlerësim nga OSHP, ndërsa AK vazhdon te beje vlerësimin e ofertave ne mënyrë te padrejte" Ne te cilin vendim specifikohet saktë se përveç OE të rekomanduar për kontrate herën e pare edhe OE qe tani është rekomanduar për kontrate OE "Toni Ingjiniering" dhe "Labinot M.Krasniqi" i kane ofruar me çmime jo normalisht te ulet."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "ELEKTRA" L.L.C., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin Neni 7, 59, 61 të LPP-Së si dhe nenin 61 të rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik Vendimi i OSHP-se Nr. 0427/2023 e dt. 14.08.2023.që të obligojë AK që të kthejë lëndën në rivlerësim dhe ta zbatoj vendimin e OSHP-së nga ku do të dalim si OE I përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët të ofertuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 788/23, ndërsa me datë 10/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0788 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, "Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje. Ndërsa OE Pajtohet me raportin e eksperti shqyrtues"

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "ELEKTRA" L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 202/0788 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti sqaron se lidhur me këtë aktivitet te prokurimit ka pasur një vendim nga OSHP me numër 427/23 14.08.2023

-Konstatimi i Ekspertit shqyrtues *pretendimi I)"OE ankues pretendon se AK ka shkelur Neni 61 të Rregullore për prokurim publik, për arsye se nuk e ka pezullua aktivitetin e prokurimit me rastin e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, Ky Nen thotë që parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim në mënyrë automatike pezullohet procedura e prokurimit dhe AK nuk ka bërë pezullimin e procedurës dhe nuk ka marr asnjë veprim edhe përkundër kërkesës sonë për rishqyrtim.* ***Përgjigje në pretendimin ankimor 1****Eksperti Shqyrtues, sqaron se në E prokurim nuk ka ndonjë dëshmi që AK ka pezulluar Aktivitetin e Prokurimit, andaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK është dashur të veproj konform Nenit 61 të Rregullave për prokurim publik."*

Përmbledhje e pretendimit ankimor 2 *"OE ankues thekson se: AK-ja duke rekomanduar për kontratë për së dytën herë një OE i cili ka çmime jo normalisht të ulëta ka vepruar në kundërshtim me LLP dhe rregullat që rregullojnë këtë fushë dhe në kundërshtim me Organit Shqyrtues te Prokurimit Nr. 2023/0427 te datës 14.08.2023, i cili vendim i përket këtij aktiviteti dhe AK Komuna e Kaçanikut gjate ri-vlerësimit nuk e ka zbatuar. Ne fazën e rivlerësimit AK vetëm e ka eliminuar OE te pare ndërsa ka vazhduar me O.E te dyte me radhe sipas ofertës e i cili është i papërgjegjshëm ne baze te ofertës qe ka dorëzuar dhe ne baze te vendimit te Panelit Shqyrtues. Ne baze te Ofertës se prezantuar shihet qarte se O.E i rekomanduar për kontrate ne shumicën e pozicioneve ka çmim jo normalisht te ulet. Ne baze te ofertave te O.E te rekomanduar për kontrate shihet qarte se i njëjti ka vendosur çmime jo normalisht të ulet për një numër të madhe të pozicioneve, çmime te cilat janë manipulative dhe nuk përkojnë as për se afërmi me çmimet e tregut. Vetëm për krahasim po i specifikojmë disa pozicione. 1.Blerja, bartja dhe montimi i shtyllave metalike konike të galvanizuara, konike, me gjatësi 8.8m dhe lirës njëkraheshe 1.5m ne formë harku sipas detalit, me elementë përcjellës si bulonat, lidhëset, dadot etj. , komplet me klemberta dhe siguresa FRA 16A. (Ofertuesi duhet te bashkëngjit në oferte vizatimin e shtyllës nga prodhuesi, atestin e prodhuesit për shtyllen e ofruar si dhe ISO*

Certifikatën e prodhuesit) ..... çmimi i ofertuar 2.5 € 2.Furnizimi dhe montimi i kuadrit shpërndarës KSHE, me dimensione 1200x600x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, tabela duhet te jete metalike e galvanizuar, siç është përshkuar ne përshkrim teknike. ..... 0.5€ 3. FID 40 A etj Njëjti ka vepruar edhe Operatori i tret me radhe Labinot Krasniqi B.I qe kane ofruar çmime jo normalisht të ulet nga te cilat vlen të listohen këto pozicione:1. Blerja, bartja dhe montimi i shtyllave metalike konike të galvanizuara, konike, me gjatësi 8.8m dhe lires njëkraheshe 1.5m ne formë harku sipas detalit, me elementë përcjellës si bulonat, lidhëset, dadot etj. , komplet me klemberta dhe siguresa FRA 16A. (Ofertuesi duhet te bashkangjet ne oferte vizatimin e shtyllës nga prodhuesi, atestin e prodhuesit për shtyllen e ofruar si dhe ISO Certifikatën e prodhuesit) ..... çmimi i ofertuar 8.5 €.2. Furnizimi dhe montimi i kuadrit shpërndarës KSHE, me dimensione 1200x600x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, tabela duhet te jete metalike e galvanizuar, siç është përshkuar ne përshkrim teknike ..... çmimi i ofruar 12€3. Ndërprerës i fuqisë As 200 A ..... çmimi i ofruar 0.5 €Vërejtje, vlen te theksohet se me vendimin me nr. 0427/2023 e dt. 14.08.2023 për të njëjtat arsye lënda është kthyer ne ri-vlerësim nga OSHP, ndërsa AK vazhdon të beje vlerësimin e ofertave ne mënyrë te padrejte ***Përgjigje në pretendimin ankimor 2****Lidhur me pretendimin ankimor të lartcekur, eksperti shqyrtues sqaron se ky AP është kthyer në rivlerësim për shkak se OE i rekomanduar për kontratë herën e parë ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta për disa pozicione dhe pas rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit, AK-ja ka vepruar njëjtë duke rekomanduar për kontratë një OE i cili po ashtu ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta të cilat janë theksuar edhe në raportin e ekspertizës nr.427/23 05.07.2023 dhe Vendimin e PSH 427/23 i dt. 14.08.2023.Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja ka kërkuar sqarime nga OE për çmimet të ofruara nga OE, mirëpo eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë janë në përputhje me çmimet e tregut pasi që hulumtimI i tregut është detyrë e Autoritetit Kontraktues, si dhe AK nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se si një OE mund të realizoj një kontratë me çmime të tilla.Tek Pozicioni nr. 28 i paramasës së OE të rekomanduar për kontratë, në këtë pozicion përfshihet;(Blerja, bartja dhe montimi i shtyllave metalike konike të galvanizuara, konike, me gjatësi 8.8m dhe lirës njëkraheshe 1.5m ne formë harku sipas detalit, me elementë përcjellës si bulonat, lidhëset, dadot etj. , komplet me klemberta dhe siguresa FRA 16A. (Ofertuesi duhet te bashkangjet ne oferte vizatimin e shtyllës nga prodhuesi, atestin e prodhuesit për shtyllen e ofruar si dhe ISO Certifikatën e prodhuesit), ky pozicion është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë me çmim 2.5 Euo për copë, ku ky pozicion ngërthen në vete shumë elemente tjera përcjellës dhe jo vetëm blerjen andaj konsideroj që ky çmim i këtij pozicioni është jo normalisht i ulët, kur në këtë lëndë janë ofruar çmime për këtë pozicion ku çmimi është rreth 140 Euro.Po ashtu edhe Pozicioni nr.33 i paramasës së OE të rekomanduar për kontratë, në këtë pozicion përfshihet (Furnizimi dhe montimi i kuadrit shpërndarës KSHE, me dimensione 1200x600x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, tabela duhet te jete metalike e galvanizuar, siç është përshkuar ne përshkrim teknike.Karakteristikat teknike:Enclosure series CDC and SDC are made of galvanized steel sheet and ëith the performance standards ISO 1461, IEC 61439-1, IEC 61439-5. Element përbërës janë:1.Nderperes magneto termike AS-160/R63A, 3p, Icc=10kA. 2. Njehsor matëse i energjisë 3f, 80A, për matje direkët 3. Siguresa automatike 3p, C, 20A , Icc=6kA=4set. 4. Konkator 3p, 230V, 25A modulare =4cope.5. Ndërprerës (0,1,2),*

2p, 16A=2cope. 6. Digital time sëitch ëith an astronomical program SHT-4 =1pcs7. Siguresa automatike 6A,1p, C, Icc=6kA. 8. Materiali i imet lidhes. 9.Në llogari hynë edhe mihja dhe betonimi i themelit të kuadratit), ky pozicion është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë me çmim 0.50 Euo për copë, ku ky pozicion ngërthen në vete shumë elemente tjera përcjellës dhe jo vetëm blerjen andaj konsideroj që ky çmim i këtij pozicioni është jo normalisht i ulët.Gjithashtu pozicioni 9 i paramasës së OE të rekomanduar për kontratë është ofruar me 0.50 Euro për copë, konsideroj që edhe ky çmim është jo normalisht i ulët.Eksperti Shqyrtues, sqaron se ka lexuar arsyetimin e sqarimeve për çmimet të OE të rekomanduar për kontratë, ku i njëjti pranon se ka ofruar çmime të ulëta, dhe ndër të tjera thekson se ka një sasi të madhe të materialit në depo, ky arsyetim është i pa pranueshëm për faktin se edhe malli në depo ka një kosto prodhimi dhe një kosto të blerjes dhe OE nuk e ka arsyetuar me dëshmi këtë situatë, andaj eksperti shqyrtues vlerëson se në sqarimet e ofruara nuk është ofrua ndonjë dëshmi reale se si mund të realizohen çmimet e ofruara, po ashtu as AK-ja nuk ka vërtetuar se si janë çmimet e tregut dhe nuk ka bërë krahasimin e çmimeve të ofruara me çmimet e tregut.

"Në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt OE pjesëmarrës "Labinot Krasniqi", për pozicionin 28 është ofruar me çmim 8.5 Euro për copë, pozicioni nr.33 i paramasës është ofruar me çmim 12 Euro për copë, pozicioni nr.4 është ofruar me çmim 0.50 Euro për copë, eksperti shqyrtues sqaron se edhe këto çmime për këto pozicione janë ofruar çmime jo normalisht të ulëta. Si përfundim Eksperti Shqyrtues e sheh pretendimin e OE ankues si të bazuar, për faktin se çmimet e Ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe çmimet të OE tjetër pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit "Labinot Krasniqi", janë çmime jo normalisht të ulëta.

Eksperti Shqyrtues, vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar në tersi Vendimin e P.SH nr.427/2023 i dt. 14.08.2023, vendim ky i cili ka obliguar Autoritetin kontraktues Citoj "që vlerësimin e ofertave ta bëjë konform dispozitave ligjore dhe çmimet e ofruara nga të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit ti hulumtoj dhe të konstatoj se a janë çmime që korrespondojnë me çmime të tregut, ngase shihen dallime të mëdha të këtyre çmimeve të ofruara nga OE" mbyll citatin . Andaj Eksperti Shqyrtues, rekomandon Panelin Shqyrtues të OSHP-së që të obligoj AK-në , që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta bëjë konform dispozitave të LPP-së, si dhe të obligoj AK që ti krahasoj të gjitha çmimet e ofertave për të gjithë OE pjesëmarrës me çmimet e tregut, në mënyrë që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në harmoni me nenin 59 të LPP-së."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues"ELEKTRA" L.L.C., Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "ELEKTRA" L.L.C., janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të obliguar AK që aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ndriçimit publik" me nr. të prokurimit: 652-23-3214-2-2-1, të kthej në Rivlerësim, pasi që konsiderohet se AK nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe kërkesave te dosjes se tenderit. Paneli Shqyrtues ka konstatuar se rivlerësimi i ofertave nuk është berë në harmoni me konstatimet dhe me gjetjet paraprake të vendimeve të OSHP-se konkretisht çmime jo normalisht te ulëta, si dhe nuk është vepruar konform dispozitave ligjore. pasi që konsiderohet se AK nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe rekomandimeve të dhëna me vendimeve paraprake të OSHP me vendimin e dates 14/08/2023 me nr. 2023/0427, andaj, ankesa e OE ankues përsëritet për herë të dytë dhe se ankesa konform Rregullores së Punës se OSHP-së konkretisht neni 16.2 te trajtohet si "Res Judicata". Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: "Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara "res judicata". Kështu që, paneli shqyrtues vjen në konstatim se AK nuk ka respektuar në tërësi vendimin në fjalë, ngase askund nuk është gjetur se AK ka bërë një hulumtim rreth këtyre çmimeve që janë paraqitur si jo-normalisht të ulëta, rrjedhimisht, paneli shqyrtues verifikon se është çështje e gjykuar me vendimin paraprak të OSHP, me çrast AK nuk iu është përmbajtur. Andaj, këto pohime ankimore paneli shqyrtues nuk ka si mos ti trajtoj ndryshe përveç çështje e gjykuar. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit me titull "Mirëmbajtja e ndriçimit publik" të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë konform dispozitave të LPP-së, si dhe të AK ti krahasoj të gjitha çmimet e ofertave për të gjithë OE pjesëmarrës (që janë palë me interes) me çmimet e tregut, në mënyrë që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në harmoni me nenin 59, 61 të LPP-së. **"**

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues Komuna Kaqanik. që në tërësi të zbatohen vendimet e OSHP. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komuna Kaqanik. që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna Kaqanik. në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**
- OE - **ELEKTRA L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: